

RIKONSTRUKSIONI

Artistët kthehen në ambientet e ribovuara të Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit

Pas një periudhe 3-vjeçare, që nga nisja e rikonstruksionit të godinës 60-vjeçare të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, artistët u rikthyen në ambientet e tyre të punës. Ministria e Kulturës, Elva Margariti vizitoi ambientet e rinovuara dhe takoi artistët e TKOBAP, solistë të operës, orkestrantë, balerinë, për t'i falenderuar për sakrificat e këtyre tre viteve, për gatishmërinë e treguar për të qenë të kundodhur, por edhe për të dëgjuar shqetësimet e tyre. "Të bindur se artistët meritojnë më shumë, ndër-morëm këtë hap të guximshëm, për të nxjerrë në dritë një nga institucionet më të rëndësishme kulturore në vend. Një investim madhor, për të cilin ia vlente pritja. Por gjithsesi, do të kisha dashur të falenderoja çdo artist, një për një për sakrificat e këtyre tri viteve; prapavijën e padukshme, por që mban një peshë të jashtëzakonshme në realizimin e një veprë dhe çdo partner që na mbështeti në këtë sfidë", tha Ministria Margariti. Ndërsa artistët kanë nisur punën në ambientet e rinovuara, vazhdon puna për përfundimin e sallës dhe skenës së shfaqjeve.

PROJEKTI

Dëmet e tërmetit, miratohet projekti i restaurimit për Kalanë e Prezës

Shumë shpejt do të nisë puna për rikonstruksionin e kalasë së Prezës, një nga monumentet më të dëmtuar, gjatë tërmetit të 26 nëntorit. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale ka miratuar projektin e restaurimit të Kalasë së Prezës në kushte të emergjencës. Projekti i hartuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore parashikon ndërhyrje konservuese dhe restauruese, në elementët konstruktivë të kullës së sahatit në kala. Kalaja e Prezës është një kala tipike mesjetare. Lulëzimin më të madh e ka pasur në shekullin XV, por të dhëna të ndryshme i kanë shtyrë të mendojnë specialistët, se duhet të jetë ndër-tuar që andej nga shekulli XIII – XIV. Kjo kala pësoi dëmtime të rënda nga tërmeti i 26 nëntorit. Nëpërmjet Drejtorisë Rajonale të Kulturës, Ministria e Kulturës mori masa të menjëhershme për vendosjen e perimetrit të sigurisë rreth monumentit dhe tabelat e rrezikut, për të ndaluar vizitorët që të afroreshin pranë mureve të kalasë.

TRASHËGIMIA

Panairi i Ndërtimit e Arkitekturës, Ministria e Kulturës prezanton projektet e restaurimit

Ministria e Kulturës mori pjesë në Panairin e Ndërtimit, Arkitekturës dhe Planifikimit Urban, për vitin 2020, që u zhvillua në Expo City. Duke e konsideruar trashëgiminë kulturore materiale si një nga prioritetet e MK, kjo e fundit u paraqit me disa projekte të rëndësishme restaurimi, udhëhequr prej motos: "Trashëgimia kulturore-motor zhvillimi". Mes projekteve të paraqitura ishte rikthimi në identitetin e Qendrës Historike të Vlorës, rikualifikimi urban dhe restaurimi i monumenteve të kulturës dhe objekteve të tjera në Dhërmë e Vuno, programin "Rrugët e besimit", ku janë përfshirë 235 objekte kulturi, kisha e xhai, duke sjellë si shembull konservimin dhe restaurimin e Manastirit të "Shën Kollit", në Mesopotam.

"Teknologjia ishte kryefjala e këtij panairi dhe përfshirja e saj në arkitekturë dhe ndërtim premtonte ngritjen e standarteve. Habitatit që na rrethon duhet ndërtuar në mënyrë të zgjuar, siç është edhe titulli i këtij panairi. Panairi i Ndërtimit do të shërbejë si një platformë e rëndësishme komunikimi për aktorët më të rëndësishëm të sektorit të ndërtimit, arkitekturës dhe planifikimit urban", u shpreh Ministria e Kulturës, Elva Margariti, gjatë ceremonisë së hapjes së panairit.

DITA E GJUHËS AMTARE

Shqipja përballë presioneve të kohës, studiuesit debat mbi problematikat

Në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit organizoi simpoziumin "Lëvizjet për gjuhë-Shqipja përballë presioneve të kohës" me pjesëmarrjen e akademikëve, studiuesve dhe profesorëve të letërsisë e gjuhës. Ky ishte aktiviteti i parë i QKLL, institucioni më ri në varësi të Ministrisë së Kulturës, ku referuan profesorët e Universitetit të Tiranës Dhurata Shehri, Anila Mullai, Anila Çepani, Diana Kastrati, Genciana Abazi nga Universiteti Europian i Tiranës, Mimoza Ahmeti nga Universiteti Mesdhetar etj. "Gjuha është pjesa më e qenësishme e identitetit të një kombi dhe madje mund të cilësohet si vetë kombi. Më vjen mirë që në vendet fqinje ka aktivitete të tilla për gjuhën tonë unike shqipe", u shpreh në hapjen e aktivitetit. Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Dorian Koçi, tha se "është pranuar gjerësisht nga të gjithë gjuhëtarët, se dialektet janë një pasuri në gjuhë, të cilat bëjnë të mundur që të përsosën më tej format shprehëse të komunikimit".

KONFERENCA

Shkrimtarët e Diasporës mbledhen në Tiranë, Margariti: Ambasadorët tanë më të mirë

Për herë të parë u zhvillua ditën e shtunë, Konferenca e Shkrimtarëve të Diasporës, organizuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko dhe me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës. Në këtë takim morën pjesë shkrimtarë, studiues e botues, si Ardian Ndreca, Bashkim Shehu, Luan Topçiu, Rudolf Marku, Anilda Ibrahim, Flutura Aça, Thanas Medi, Entela Tabaku, Anisa Markarian, Besa Myftiu, Arben Dedja etj. Ministri Pandeli Majko vlerësoi kontributin e shkrimtarëve të diasporës, që nis që me Frashërlinjët, deri në ditët tona. Po ashtu, Ministria Elva Margariti i quajti ata "ambasadorët në të mirë" të Shqipërisë. "Viteve të fundit Ministria e Kulturës ka mbështetur përkthimin e shkrimtarëve shqiptarë në gjuhë të huaj, në një kohë që shkrimtarët e diasporës e kanë bërë këtë, pa mbështetje institucionale, duke promovuar jo vetëm veten e tyre, por edhe një copëz Shqipërie, që do të jetë gjithnjë me ta. Organizimi i Konferencës së Shkrimtarëve të Diasporës është dëshmia e vlerësimit që shteti shqiptar ka karshi tyre dhe ftesa për një dialog dhe bashkëpunim të mëtejshëm", tha ajo.